



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 10.04.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 04.04.2025, të parashtruar nga Operatori Ekonomik Gentian Sakaj B.I., lidhur me aktivitetin e prokurimit “Servisimi i automjeteve zyrtare-Kontratë dy vjeçare”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-1497- 2-1-1, Nr. i brendshëm-632-25-016-211, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit ekonomik Gentian Sakaj B.I., e dt.04.04.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Servisimi i automjeteve zyrtare-Kontratë dy vjeçare”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-1497- 2-1-1, Nr. i brendshëm-632-25-016-211, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të datës 10.03.2025, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
- 2. Vërtetohet** DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të publikuar me datë: 10.03.2025;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori ekonomik Gentian Sakaj B.I., me dt.04.04.2025, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Servisimi i automjeteve zyrtare-Kontratë dy vjeçare”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-25-1497- 2-1-1, Nr. i brendshëm-632-25-016-211.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 10.04.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi se gjoja është shkelë Neni 17.17 të Rregullores Nr. 001/2022 të Prokurimit publik, ky pretendim është plotësisht i pabazuar. Komuna jonë e ka pasur parasysh natyrën e lëndës përkatësisht shërbimin i cili bëhet gjatë implementimit kontratës.

Nga Komuna e Gjakovës, çdo herë veturat dërgohen në servisim nga vozitësi, i cili në të njëjtën kohë është edhe Menaxher i Kontratës dhe i cili duhet të jetë prezent gjatë servisimit të rregullt të veturës si dhe gjatë identifikimit të defekteve.

Gjithashtu, Menaxheri (vozitësi) është i obliguar që të kthehet në Komunë, për të marrë miratimin apo mosmiratimin e urdhërit të punës, pa të cilin nuk mund të vazhdohet me tutje.

Andaj pretendimi juaj që: "Distanca rrugore nga objekti komunal në Gjakovë maksimum 10 (dhjetë) km është kriter që favorizon një kompani të caktuar dhe e kufizon pjesëmarrjen e shumë OE në këtë tender", **nuk qëndron...**

Gjithashtu ju keni potencuar se: "Operatori Ekonomik fitues i mundshëm i kontratës për Servisimin dhe Mirëmbajtjen e Veturave të KK Gjakovë; largësia e të cilit ndodhet më shumë se 10Km nga baza kryesore, obligohet ta bëjë transportin e veturave nga baza kryesore e saj dhe deri të autoservisi i Operatorit Ekonomik si dhe anasjlltas, për servisimin dhe mirëmbajtjen e veturave me Shpenzimet e Operatorit Ekonomik pra të fituesit të kontratës".

**Duke argumentuar që pretendimi i juaj nuk qëndron, po i renditi disa arsye:**

1. Për shkak të efektit kohë, sepse Menaxheri i Kontratës duhet të udhëtoj mbi 80 km në të dy drejtimet dhe lind pyetja se kush do t'ia kompensoj kohën e humbur kur Ai ka edhe punë tjera si dhe maltretimi që i bëhet në dy drejtimet;
2. Shpenzimet për shkak të distancës, dhe këtu shtohet faktin që asnjë automjet nuk mund të bartet pa qenë prezent zyrtari apo vozitësi;
3. Zyrtari apo vozitësi nuk lejohet të udhëtoj me kamion, dhe si barrë dhe kosto shtesë për Komunën, është se ai duhet të shkoj deri të servisi me një automjet tjetër;
4. Ndërsa Kamioni për bartje të veturës është kërkuar, për bartje të veturës në rastet kur defekti ndodhë rrugës apo në parkingun e Komunës së Gjakovës dhe është e pamundur që vetura të dërgohet ndryshe në Autoservis.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Faton Gutaj

për: *Xh. Hoxha*  
Menaxheri Zyrës së Prokurimit

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;  
Zyrës së Kryetarit të Komunës;  
Te gjitha palëve të interesuara;